

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Global Agency Services” SH.P.K

Sot më datë 04/07/2023 (dymijë e njëzet e tre), ortakët themelues:

- **Z. Darjo JASHARI**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më 11.12.1996, mbajtës i pasaportes BE4362392, me Numer Personal J61211044A, me zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar.
- **Z. Glen RRYTA**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 20.09.1988, mbajtës i kartës së identitetit 037927329, me Numer Personal I80920080P, me zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar.

kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, ËMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1— Forma

- 1.1 Shoqëria "**Global Agency Services** " **Sh.p.k.** në vijim ("Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çeshtjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 — Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është "**Global Agency Services**" **SH.P.K**

Neni 3 — Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

Agjensi doganore, spedicionare e detare, komisionere, shërbime të ndryshme, transport mallrash brënda dhe jashtë vendit. Shërbime Servis për mjete lundrues. Shiphandler- Ofrimin e furnizimeve në ushqime dhe pajisje për anijet.

Neni 4 — Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga Tregtare, Lagjia nr.1, Porti Detar, Durrës, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5 — Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

- 5.2 Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblese së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 — Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000.00 (njëqind mijë) Leke.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 2 (dy) kuota, të nënshkruara në të holla, me vlerë nominale 50'000 (pesëdhjete mijë) Leke secila;

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- **Z. Darjo JASHARI** do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me lekë 50'000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, nëpërmjet depositimit në llogarinë bankare të shoqërisë në themelim e sipër.
 - **Z. Glen RRYTA** do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me lekë 50'000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, nëpërmjet depositimit në llogarinë bankare të shoqërisë në themelim e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërm:
- **Z. Darjo JASHARI**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50'000.00 lekë (pesëdhjetë mijë), e cila përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Z. Glen RRYTA**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50'000.00 lekë (pesëdhjetë mijë), e cila përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8 — Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejten të nënshkruajnë rritjen në raport me pjeset e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 — Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën kufijt e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjten masë me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre.



Neni 10 — Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke përfshirë ketu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen në parablerje ortakeve të tjere.
- 10.3 Në nje rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar per shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marreveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejten e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie "*mortis causa*" ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblese së Ortakëve. Në marrjen e vendimit të Asamblesë së Ortakëve duhet të jenë të pranishern ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjeteenjë përqind) të kapitalit themeltar, dhe vendimi duhet të merret me votë pro të paktën 3/4 (tre të katërtat) të ortakëve të pranishëm. Në rast se nuk arrihet një vendim pro transferimit të kuotave, atëherë do të procedohet me likuidimin e kuotës së trashëgimisë. Përcaktimi i vlerës së kuotës të vënë në likuidim do to kryhet me marrëveshje midis palëve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, palët, me marrëveshje midis tyre do të emërojnë një vlerësues i cili do të përcaktoje vlerën e kuotës që do të likuidohet. Ne rast se nuk arrihet një marreveshje as në këtë pikë, vlerësuesi do të emërohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë me kërkesën e palës së interesuar.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 — Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjese për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërise, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.



Neni 12 — E drejta e pjesernarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejte të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të perfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 — Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që perfaqësojnë të paktën 5% (pesë perqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve — në adresën e ortakëve ose nëpërmjet emailit në adresën elektronike të secilit ortak dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të nderhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejte vote që zoterojnë me shume se 30% (tridhjetë perqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejte vote që zoterojnë të paktën 51 % (pesëdhjetë e një perqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 3/4 (tre të katërtave) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një perqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zoterojnë me shumë se 30% (tridhjetë perqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

Neni 14 — Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vjeçare

Administrator i shoqërisë emërohet Z. Darjo Jashari, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.12.1996, identifikuar me pasaporte me nr. Personal J61211044A

- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 — Audituesi Ligjor

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Audituesi ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BALANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombëtare Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHQERISE

Neni 18 — Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga Ligji, ose me anë të një vendimi të asamblese së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotesise per të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 — Likuidimi

- 19.1 Në rast shpërbërjeje, shoqëria do të vendoset në likuidim
- 19.2 Për ta administruar këtë procedure, Asambleja emëron një ose me shumë likuidatore, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në pergjithësi midis ortakëve (perveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejte ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Neni 21 — Dispozita të fundit

- 21.1 Ky Statut është hartuar ne 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa verejtje nga ortakët themelues në vendin e krijimit.
- 21.2 Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë status do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Darjo JASHARI



Glen RRYTA

